



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës
së Prishtinës, mbajtur më 17. 1.2013, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Engin Beyoglu, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Para se të fillonin me rendin e ditës, kryesuesi propozoi që në këtë mbledhje të shqyrtohet edhe Propozimvendimi për dhënien e pajisjeve në shfrytëzim NPL "Hortikultura" SH.A. Prishtinë dhe Propozimvendimi për subvencionimin e mjeteve financiare NPL "Hortikultura" SH. A. Prishtinë.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dymbëdhjetë;
2. Informata për arkëtimin, shpenzimet dhe investimet për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2012;
3. Propozimvendimi për caktimin e tre (3) anëtarëve të ekzekutivit të Komunës në komisionin vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim;
4. Propozimvendimi për dhënien e strehimores publike në shfrytëzim të përkohshëm Qendrës Rinore në Prishtinë;
5. Propozimvendimi për dhënien e trafos në shfrytëzim KEK-ut - Distribucionit të shpërndarjes, Njësia në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë;
7. Propozimvendimi për dhënien e pajisjeve në shfrytëzim NPL "Hortikultura" SH.A. në Prishtinë;

Faqe 1 nga 5

8. Propozimvendimi për subvencionimin e mjeteve financiare NPL "Hortikultura" SH.A. në Prishtinë ;
9. Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2012/2013;
10. Të ndryshme.

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dymbëdhjetë.

Pika e dytë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi kryesuesi.

Shefqet Sylejmani tha se sukcesi i Komunës së Prishtinës është sukses i të gjitha grupeve parlamentare. Prishtina është model për të gjitha komunat e Kosovës. Kjo informatë përveç që është e pranueshme për mua dhe grupin tim parlamentar, është edhe e suksesshme. Prishtinës nuk i ka hije ndryshe, përveçse të veprojë kështu. Në pjesën teknike, duhet bërë përmirësime në aspektin gjuhësor.

Tefik Mehmeti theksoi se arkëtimi, shpenzimet dhe investimet janë në përqindjen e përgjithshme të planifikuar dhe shpenzimet mbi 30%, qëndrojnë për shkak se punët kryhen në fund të vitit, andaj dhe informata është e pranueshme.

U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për arkëtimin, shpenzimet dhe investimet për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2012 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi Agim Salihu.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë.

Aziz Pacolli theksoi se secili anëtar i komisioneve duhet të jetë banor i Prishtinës, andaj desha të dijë se anëtarët e propozuar nga Kryetari dhe ata që do të propozohen në Kuvend, a janë banorë të Prishtinës. Nuk është në rregull që një këshilltar i Komunës tjetër ta udhëheq një komision të tillë.

Shemsi Veseli pyeti lidhur me mënyrën e caktimit të këtij komisioni dhe kompetencat e tij.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë dhe u përgjigj në pyetjet e parashtruara.

Tefik Mehmeti propozoi Mustafë Krasniqin, ndërsa nga komunitetet u propozua Engin Beyoglu.

Shemsi Veseli propozoi Shefqet Sylejmanin, duke shtuar se Astrit Hasani është edhe në komisione të tjera.

Aziz Pacolli bëri vërejtje në atë që partia më e madhe opozitare po anashkalohej dhe se **Astrit Hasani** është anëtar edhe i shumë komisioneve të tjera.

Milazim Vitia kujtoi se edhe në mbledhjen e kaluar pati vërejtje në atë se partia më e madhe opozitare po anashkalohej gjatë caktimit të anëtarëve të komisioneve të ndryshme.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë.

Mustafë Krasniqi shtoi se çështja e propozimit të kryesuesit lidhur me caktimin e **Astrit Hasanit**, ka të bëjë me këtë komision, e jo me anashkalime partiake.

Tefik Mehmeti u shpreh i pajtimit që të bëhet ndërrimi, në mënyrë që në vend të **Astrit Hasanit**, të jetë **Shefqet Sylejmani**, pasi që **Astrit Hasani** është duke vijuar shkollimin dhe mund të mungojë.

Hazir Borovci shtoi se përvoja dhe njohuria e **Shefqet Sylejmanit**, do ta ndihmoj mjaft punën e këtij komisioni, andaj e përkrah këtë propozim, pasi që është në interes të përbashkët.

Shemsi Veseli shtoi se propozimi i **Aziz Pacollit** është mirë të merret parasysh për herët tjera.

Shefqet Sylejmani u shpreh në përkrahje të asaj se çka po vendos komiteti, të cilin tërë kohën e ka përkrahur, por duhet të diskutoni edhe me partitë parlamentare.

Anëtare të këtij komisioni e propozoi **Ajshe Nuhiun**, ish-pedagoge, tani udhëheqëse e OJQ "Vita - Jeta".

U konstatua se me shumicë votash, me dy abstenime, u përkrah Propozimvendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Gashi**.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e strehimores publike në shfrytëzim të përkohshëm Qendrës Rinore dhe programit " Laboratori Inovativ" i UNICEF-it në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për miratim.

Pika e pestë

Arsyetimin për këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti **Agim Gashi**.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e trafos në shfrytëzim KEK-ut - Distribucionit të shpërndarjes, Njësia në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për miratim.

Pika e gjashtë

Përkitazi me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Salihu**.

Faqe 3 nga 5

Shefqet Sylejmani tha se këtij propozimi, për shkak të paqartësisë në paragrafin e shtatë të arsyetimit, pas fjalës "shëndetësisë", duhet shtuar një presje.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për miratim.

Pika e shtatë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Gashi**.

Aziz Pacolli shprehu kënaqësinë që këto pajisje i janë dhënë NPL "Hortikultura", por shtoi se ata duhet të kenë përgjegjësi më të madhe.

Tefik Mehmeti u shpreh se ndërmarrjeve komunale është më mirë të u jepen pajisje sesa subvencione, përveç kur këtë e dikton specifika e ndërmarrjes.

Shemsi Veseli përkrahu këtë propozim, që këto mjete të vihen në shfrytëzim, por për shkak të transparencës, duhet të kemi një marrëveshje paraprake.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e pajisjeve në shfrytëzim NPL "Hortikultura" SH.A. në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për miratim.

Pika e tetë

Agim Gashi paraqiti arsyetimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë.

Shefqet Sylejmani propozoi që në lagjen "Kodra e Diellit", në kompleksin banesor "Dielli", të mbillen drurë dhe të hapet pusi.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për subvencionimin e mjeteve financiare NPL "Hortikultura" SH.A. në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për miratim.

Pika e nëntë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Halim Halimi**.

Shemsi Veseli tha se kjo informatë është mjaft e thukët, ku është përshkruar gjendja faktike, por kjo është edhe brengë e shoqërisë.

Shefqet Sylejmani përkrahu vlerësimet e **Shemsi Veselit**, por tha se mungojnë masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes. Në faqen e dytë, paragrafi i tretë, në vend të: "bukur shumë i fryrë", të jetë: "është aplikuar kriteri më i butë i vlerësimit".

Halim Halimi paraqiti sqarime shtesë.

U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2012/13 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

**Pika e dhjetë
Të ndryshme**

Aziz Pacolli ngriti çështjen e emërimit të rrugëve, shënimin e tyre, duke thënë se kjo duhet të bëhet për të gjitha lagjet dhe rrugët e Prishtinës.

Mbledhja mbaroi në orën 17:15.

**PROCESMBAJTËSE:
Alije Gusia**

**KRYESUESI I KOMITETIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.**